



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 013 -23
Me 30.05.2023
Mamushë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, nenit 65 dhe 67 të Statutit të Komunës së Mamushës e datës 01.12. 2008, në mledhjen e mbajut me datën 30.05.2023 Kuvendi Komunal miratoi këtë:

V E N D I M

Për Zëvendësimin e Anëtarëve të Komitetit Për Komunitete.

Neni 1

Zëvendësimi e Anëtarëve të Komitetit për Komunitete

Me anë të këtij vendimi zëvendësohen dy anëtar për Komitetin për Komunitete kjo për shkak të dorëheqjes së tyre. Andaj, në vend të Adnan Zogaj nga Komuniteti Shqiptar për shkak të dorëheqjes së tij e zëvendëson z. Irfan Zogaj po ashtu nga Komuniteti Shqiptar.

Në vend të z.Nexhmedin Shala nga Komuniteti Rom për shkak të mos pjesëmarrjes së tij në më shumë se 3 mbledhje radhazi konform Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 nenit 12 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 i pushon mandati si Anëtar andaj, do të zëvendësohet me z. Kujtim Berisha po ashtu nga Komuniteti Rom.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat dhe përgjegjësitë e Anëtarëve të Komiteteve janë të parapara në neni 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 65 dhe 67 të Statutit të Komunës së Mamushës, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë.

Neni 3

Hyrja në Fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyten e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtate) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës

Njoftohen

1. Palët
2. MAPL
3. ARKIVI

